

**VENDIM**  
**Nr. 86, datë 3.8.2016**

**PËR DHËNIEN E MIRATIMIT PARAPRAK PËR KRYERJEN E VEPRIMTARIVE**  
**SHTESË NGA BANKA AMERIKANE E INVESTIMEVE SHA**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 12, shkronja “a”, nenit 43, shkronjat “c” dhe “e”, të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, “Për Bankën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të nenit 23, pikat 1 dhe 3, nenit 24, pika 1, shkronja “ç” dhe të nenit 54, pika 2, shkronja “b”, shkronja “dh”, nënpika “v”, shkronja “e”, nënpikat “i” dhe “ii” dhe shkronja “ë” të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006, “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe të rregullores “Për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë së bankave dhe degëve të bankave të huaja në Republikën e Shqipërisë”, miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 14, datë 11.3.2009, e ndryshuar, me propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

**VENDOSI:**

1. Të japë miratimin paraprak për kryerjen nga Banka Amerikane e Investimeve sh.a. të veprimtarive financiare shtesë, si më poshtë:

- a) *Factoring*-un dhe financimin e transaksioneve tregtare;
- b) Tregtimin për llogari të saj ose për llogari të klientëve, qoftë dhe në një këmbim valutor, në një treg të vetorganizuar (OTC) ose ndryshe, të letrave me vlerë të transferueshme.
- c) Ndërmjetësimin për transaksionet monetare të mëposhtme:
  - i) Administrimin e aktiveve, të tilla si: administrimi i parave dhe i portofolit, administrimi i fondeve, marrja në kujdestari, shërbimet depozi-tuese dhe të besimit;
  - ii) Shërbimin për kompensimin dhe shlyerjen e pagesave të aktiveve financiare, duke përfshirë letrat me vlerë, produktet derivative dhe instrumente të tjera të negociueshme;
- d) Shërbimet këshilluese, ndërmjetëse dhe shërbime të tjera ndihmëse për të gjitha veprimtaritë e listuara më sipër, duke përfshirë referencën e kredisë dhe të analizës, kërkimin dhe këshillimin në lidhje me investimet dhe portofolin, si dhe këshillimin mbi blerjet e mbi strategjinë dhe ristrukturimin e shoqërive.

2. Autorizohet Guvernatori i Bankës së Shqipërisë për të kryer ndryshimet përkatëse në aneksin e licencës së Bankës Amerikane të Investimeve sh.a., sipas pikës 1 të këtij vendimi.

3. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes për zbatimin e këtij vendimi.

4. Ngarkohet Departamenti i Kërkimeve për publikimin e këtij vendimi në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë, si dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI**  
**Gent Sejko**